



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe Marrëveshjes për bashkëpunim mes OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve –VORAE dhe Komunës së Lipjanit 1-016-4780 e datës 25.01.2018, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

**Neni 1**

**Formimi i Komisionit dhe përbërja**

Me këtë Vendim, konform dispozitave të Marrëveshjes për bashkëpunim mes OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve dhe Komunës së Lipjanit 1-016-4780 e datës 25.01.2018, **formohet** Komisioni verifikues ( në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Lorik Berbatovci, Qendra për punë Sociale, Kryesues
2. Ymer Bikliqi, Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
3. Gradimir Zarkovic, Zyra Lokale për Komunitete , anëtar

**Neni 2**

**Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi që konform dispozitave të Marrëveshjes për bashkëpunim mes OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve dhe Komunës së Lipjanit 1-016-4780 e datës 25.01.2018, të bëj verifikimin dhe realizimin e vizitave për verifikimin e zbatimit praktik të Marrëveshjes së cekur qëllimi i së cilës është realizimi i Projektit “ **Përfshirja Sociale dhe pëmirësimi i kushteve të jetës për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe grupe të tjera të cenuara në Kosovë** ” me theks të veçantë në komponentën e pëmirësimit të kushteve të banimit përkatësisht ndërtimin dhe renovimin e objekteve të banimit .

Komisioni do të raportoj te Kryetari i Komunës me foto dhe me raport të shkruar për progresin e punës i cili do të arsyetoj faturat dhe i cili raport do të shëbej për pagesën e tri kisteve të cilat janë të ndërlidhura me kryerjen e punëve konform Marrëveshjes.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit si dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

INr. 016 - 5897

Lipjan, më 31.01.2018

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

